

RAPORT

1

MONITORIMI I BUXHETIT TË SHQIPËRISË PËR SHËNDETËSINË:

- SHTATOR - DHJETOR 2021
- JANAR - PRILL 2022

2

RIMBURSIMI I PAKETËS ANTI-COVID

- 2021
- JANAR - PRILL 2022



Të gjitha të drejtat në këtë dokument, përfshirë të drejtat e autorit, janë në pronësi të Fondacionit Westminster për Demokraci (WFD) dhe mbrohen nga ligjet e zbatueshme të Mbretërisë së Bashkuar dhe ato ndërkombëtare. Ky dokument nuk mund të kopjohet, ndahet, përkthehet në një gjuhë tjetër, apo të përshtatet pa leje paraprake nga WFD.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Informacioni dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë ato të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionin zyrtar të WFD-së, financuesve të saj apo Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar. As WFD dhe as ndonjë person që vepron në emër të saj, nuk mund të mbahet përgjegjës për përdorimin që mund t'i jetë bërë informacionit që ai përmban.

Gusht 2022

Tabela e përmbajtjes

PJESA I

Monitorimi i buxhetit të Shqipërisë për shëndetësinë 2021

- shtator - dhjetor 2021
- janar - prill 2022

Shkurtime.....	5
Lista e grafikëve	6
Lista e tabelave	7
Hyrje.....	8
Gjetjet kryesore	9
1. Përmbledhje ekzekutive	11
2. Realizimi i buxhetit total dhe programeve të MSHMS, viti 2021 dhe 4 M III 2021.....	16
<i>I. Planifikim, Menaxhim, Administrim</i>	20
<i>II. Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor</i>	21
<i>III. Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor</i>	22
<i>IV. Shërbime të Shëndetit Publik</i>	23
<i>V. Shërbimi Kombëtar i Urgjencës Mjekësore</i>	24
3. Zbatimi i programeve, sipas zërave 4-mujori i parë 2022.....	25
4. Vdekshmëria shtesë për vitin 2021 dhe T I 2022.....	29
5. Ecuria e procesit të vaksinimit	34
6. Pasojat afatgjata të COVID-19 në shëndetin e popullatës.....	34
7. Konkluzione.....	36
8. Rekomandime	36

PJESA II

Rimbursimi i paketës anti-COVID, 2021, janar - prill 2022

Gjetjet kryesore	39
1. Përmbledhje ekzekutive	40
2. Efektiviteti i paketës financiare për të sëmurët me COVID-19 në vitin 2020	42
3. Rimbursimi për të sëmurët me COVID-19 në vitin 2021	43
4. Rimbursimi për të sëmurët me COVID-19 në periudhën janar - prill 2022	44

5. Përlogaritja e kostove të rimbursimit në paketën anti-COVID-19	45
6. Të sëmurët u përballën me kosto të larta të kurimit jashtë spitalit	47
7. Aneks 1 - Kosto e kurimit jashtë spitalit.....	49
8. Paketa anti-COVID nuk pati interes nga të infektuarit.....	49
9. Aneks 2 - Dëshmitë e mjekëve dhe farmacistëve	50
10. Kapacitete të dobëta financiare për të mbrojtur financiarisht të infektuarit.....	50
Referenca	51

Shkurtime

PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
FSDKSH	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor
VKM	Vendime të Këshillit të Ministrave
QSUNT	Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”
ISHP	Instituti i Shëndetit Publik
QKUM	Qendra Kombëtare Urgjencës Mjekësore
QKMZHF	Qendra Kombëtare e Mirërritjes dhe Zhvillimit të Fëmijëve
MEF	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
4MI	4 majori i parë
4MII	4 majori i dytë
4M III	4 majori i tretë
WFD	Fondacioni Westminster për Demokraci (Westminster Foundation for Democracy)

Kursi mesatar i këmbimit 2021¹ 1 Euro = 122 lekë

¹ Burimi: Banka e Shqipërisë

Lista e grafikëve

PJESA I

Grafiku 1: Norma reale e rritjes së PBB (%), 2010-2021

Grafiku 2: Treguesit fiskalë të konsoliduar të buxhetit të shtetit, periudha 2020-2021

Grafiku 3: Treguesit fiskalë të konsoliduar të buxhetit të shtetit, 4 M I, periudha 2011-2022

Grafiku 4: Realizimi i shpenzimeve të buxhetit të shëndetësisë, sipas programeve të miratuara, 2018-2021

Grafiku 5: Realizimi i shpenzimeve të buxhetit sipas programeve të miratuara, shtator-dhjetor, 2020-2021

Grafiku 6: Realizimi i shpenzimeve të buxhetit të shëndetësisë, sipas programeve të miratuara, janar- prill 2019-2022

Grafiku 7: Realizimi i shpenzimeve të buxhetit të shëndetësisë, sipas programeve të miratuara, janar- prill 2019-2022

Grafiku 8: Realizimi i buxhetit të shëndetësisë, sipas produkteve kryesore, 2019-2021

Grafiku 9: Programi "Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor", sipas produkteve kryesore, shtator-dhjetor, 2020-2021

Grafiku 10: Programi "Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor", sipas produkteve kryesore, shtator-dhjetor, 2020-2021

Grafiku 11: Programi "Shërbime të Shëndetit Publik", sipas produkteve kryesore, shtator-dhjetor, 2020-2021

Grafiku 12: Programi "Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor", sipas produkteve kryesore, janar-prill, 2021-2022

Grafiku 13: Programi "Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor", sipas produkteve kryesore, janar-prill, 2021-2022

Grafiku 14: Programi "Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor", sipas produkteve kryesore, janar-prill, 2021-2022

Grafiku 15: Programi "Shërbime të Shëndetit Publik", sipas produkteve kryesore, janar-prill, 2021-2022

Grafiku 16: Vdekjet, (nr.) periudha 2011-2021

Grafiku 17: Vdekjet sipas tremujorëve (nr.)

Grafiku 18: Rritja e vdekshmërisë, 2020-2021 kundrejt mesatares 2016-2019 (%), Europa

Grafiku 19: Vdekjet sipas tremujorëve në pandemi 2020-2021, krahasuar me mesataren 2016-2019 (nr.)

PJESA II

Grafiku 20: Parashikimi dhe ecuria e përfituesve nga paketa anti-COVID me 2020

Grafiku 21: Ecuria e Rimbursimit të Fondeve për të Sëmurët COVID-19

Grafiku 22: Personat përfitues dhe shuma e shpërndarë (në lek) nga paketa anti-COVID-19

Grafiku 23: Shpenzimet publike në shëndetësi (%)

Lista e tabelave

PJESA I

Tabela 1: Realizimi i shpenzimeve të buxhetit të shëndetësisë, sipas programeve të miratuara, 2018-2021 (mln lekë)

Tabela 2: Realizimi i shpenzimeve të buxhetit sipas programeve të miratuara, shtator-dhjetor, 2020-2021 (mln lek)

Tabela 3: Realizimi i shpenzimeve të buxhetit të shëndetësisë, sipas programeve të miratuara, janar- prill 2019-2022 (mln lekë)

PJESA II

Tabela 4: Rimbursimi i pacientëve, që kanë përfituar nga paketa anti-COVID, nëntor 2020 - prill 2022

Hyrje

Ky raport është vazhdimësi e raporteve për “Monitorimin e Buxhetit të Shqipërisë për Shëndetësinë, Janar – Prill 2021² dhe Janar - Gusht 2021³”, mbështetur nga zyra e WFD në Shqipëri dhe përgatitur nga shoqata “Together for Life” në shtator 2021.

Në këtë raport janë përfshirë në analizë të dhënat për vitin e plotë 2021, duke ofruar një panoramë më të plotë të zhvillimeve përkatëse, krahas aktivitetit të detajuar për katër mujorin e fundit të 2021, në vijimësi edhe të dhënave për dy katërmujorët e parë të vitit 2021. Në raport jepet një panoramë e detajuar e shpenzimeve të Ministrisë së Shëndetësisë edhe për periudhën janar - prill 2022.

Raporti analizon të dhënat zyrtare të përdorura nga Ministria e Financave për buxhetin faktik 2021, raportet e monitorimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dhe statistika të tjera të publikuara nga INSTAT lidhur me vdekjet gjatë periudhës së pandemisë. Janë përfshirë dhe të dhënat paraprake për gjysmën e parë të vitit 2022.

Të dhënat e raporteve të monitorimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale publikohen në bazë 4-mujore, ndërsa të dhënat e tjera për ecurinë e treguesve ekonomikë dhe statistikat e vdekshmërisë publikohen nga institucionet përkatëse me bazë tremujore, ose mujore. Për këtë arsye, të dhënat për monitorimin e shpenzimeve të shëndetësisë do të raportohen për periudhë 4-mujore dhe vjetore, ndërsa të dhënat e tjera për periudhën vjetore, ose tremujore.

² <https://www.wfd.org/what-we-do/resources/monitoring-state-budget-health-albania>

³ <https://www.wfd.org/what-we-do/resources/monitoring-state-health-budget-albania>

Gjetjet kryesore

Shpenzimet për sektorin e shëndetësisë arritën në nivel rekord **në vitin 2021**, të ndikuara nga rritja e trajtimit të të shtruarve në spitale për shkak të ngarkesës së krijuar nga pandemia e COVID-19, procesi i vaksinimit kundër COVID-19, fillimit të aktivitetit të koncesionit të laboratorëve dhe kredisë së Bankës Botërore për përballimin e pasojave të pandemisë.

Për gjithë vitin 2021, shpenzimet totale faktike për shëndetësinë ishin 78 miliardë lekë (642 milionë Euro), me një rritje prej 16% me bazë vjetore në krahasim me periudhën përkatëse 2020, ose 10.8 miliardë lekë (88 milionë Euro) më shumë.

Në krahasim me vitin 2019, kur vendi ishte në një periudhë normale shëndetësore, shpenzimet për shëndetësinë janë rritur ndjeshëm me 28%, të ndikuara nga programet e “Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Dytësor”, “Shërbimeve të Shëndetit Publik” dhe “Përkujdesit Social”.

Për shkak të ngarkesës që u krijua në spitale në vitin 2021, sidomos gjatë gjysmës së parë të vitit, është rritur ndjeshëm fondi për “Trajtimin e pacientëve të shtruar në spitale”, duke u zgjeruar me 19%, ose 3.7 miliardë lekë (30 milionë Euro) më shumë, për vitin 2021, në raport me 2020-n.

“Persona të vaksinuar me vaksinën anti COVID-19”, është një zë i ri që u zbatua për herë të parë në vitin 2021, në kuadër të programit për vaksinimin kundër COVID-19, me një fond total për vitin 2021 prej 3.5 miliardë lekë (28.5 milionë Euro).

Në 4 mujorin e tretë të vitit 2021, shpenzimet totale faktike për shëndetësinë ishin 29 miliardë lekë (240 milionë Euro), me një rritje prej 18.1% me bazë vjetore, ose 4.5 miliardë lekë (37 milionë Euro) më shumë.

Rritja e shpenzimeve në katër mujorin e fundit 2021 u udhëhoq nga fillimi i projektit të kredisë së Bankës Botërore për përballimin e pasojave të COVID-19 dhe fillimit të zbatimit të kontratës së koncesionit të ekzaminimeve laboratorike.

Shpenzimet për “Trajtimin e pacientëve të shtruar në spitale” u rritën me ritme më të ngadalta në 4-mujorin e tretë, ndërsa “Numri i vizitave në Kujdesin Shëndetësor Parësor”, shfaqti tendencë rënieje.

Në katër mujorin e parë të vitit 2022, shpenzimet totale për shëndetësinë shfaqën rënie për herë të parë që nga fillimi i pandemisë. Totali i shpenzimeve për periudhën janar - prill 2021 ishte 23.4 miliardë lekë (192 milionë Euro), me rënie 2.7% në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Tkurrja erdhi kryesisht nga ulja e shpenzimeve për “Pacientët e trajtuar në spitale” dhe ritmet më të ngadalta të vaksinimit.

Vdekshmëria shtesë vijoi të ishte e lartë në vitin 2021, e ndikuar nga shtimi i ndjeshëm i fataliteteve në periudhën janar - mars. Për vitin 2021, në vend u regjistruan 30,580 vdekje,⁴ me një rritje prej 10.8% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2020, kur vendi u përball me valën e parë të pandemisë. Në raport me mesataren 2016-2019, periudhë që merret si referencë për krahasimin e vdekshmërisë shtesë të shkaktuar nga pandemia, rritja arrin në 40%.

Në tremujorin e parë 2022, rritja e vdekshmërisë shtesë u ngadalësua në raport me vitin e mëparshëm, por sërish mbetet më e lartë se në periudhën e para pandemisë, duke treguar jo vetëm pasojat direkte të COVID-19, por edhe implikimet që ajo solli në shëndetin e popullatës, si dhe efektet e mungesës së kurimit dhe diagnostikimit të sëmundjeve të tjera gjatë periudhës së karantinës.

Në tremujorin e parë 2022 u shënuan gjithsej 7,837 humbje jete⁵, me rënie 22% në raport me të njëjtën periudhë të 2021, por me rritje 25% në krahasim me mesataren përkatëse 2016-2019.

Pavarësisht përshpejtimit të procesit, Shqipëria mbetet ndër të fundit në Evropë sa i përket vaksinimit, në raport me popullatën. Deri në fund të vitit 2021, Shqipëria kishte 2,396,863 vaksinime anti-COVID⁶. Nga dozat e vaksinës anti-COVID, të kryera në Shqipëri ishin: 1,147,753 doza të para, 1,040,493 doza të dyta dhe 147,507 doza të treta. E vaksinuar me të paktën me një dozë ishte rreth 41% e popullsisë.

Vaksinimi ka vijuar me ritme më të ngadalta edhe në muajt e parë të vitit 2022. Deri në fund të muajit prill 2022 ishin kryer 2,814,626 vaksinime gjithsej⁷. E vaksinuar me të paktën me një dozë ishte rreth 46% e popullsisë (1,293,234 doza të para) deri në fund të muajit prill 2022.

⁴ <http://instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/lindjet-vdekjet-dhe-martesat/publikimet/2021/treguesit-demografik%C3%AB-t4-2021/>

⁵ <http://instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/lindjet-vdekjet-dhe-martesat/publikimet/2022/treguesit-demografik%C3%AB-t1-2022/>

⁶ <https://shendetesia.gov.al/vaksinimi-anticovid-2396863-vaksinime/>

⁷ <https://shendetesia.gov.al/vaksinimi-anticovid-2814626-vaksinime/>


1. Përmbledhje ekzekutive

Në periudhën 2020-2021, Shqipëria, ashtu si gjithë globi, u përball me pandeminë e COVID-19, që shkaktoi pasoja të rënda në ekonomi dhe sidomos në humbjen e jetëve njerëzore.

Në vitin 2020, pasojat e pandemisë ishin shumë të forta në ekonomi, duke shënuar një rënie prej 3.5% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB), më e forta që nga viti 1997. Në vitin 2021 ekonomia shfaq shenja të forta rigjallërimi, duke u rritur me 8.54%⁸, e ndikuar nga përmirësimi i aktivitetit në të gjithë sektorët, sidomos tregtia dhe shërbimet, që ishin goditur më fort gjatë pandemisë.

Rritja vijoi dhe në 3-mujorin e parë 2022 me 5.97%, e udhëhequr nga tregtia e shërbimet, ndërtimi dhe pasuritë e paluajtshme.

Grafiku 1: Norma reale e rritjes së PBB (%), 2010-2021



Burimi: INSTAT


Në vijim të ecurisë së mirë të ekonomisë, të ardhurat buxhetore kanë shënuar gjithashtu rritje të ndjeshme. Për vitin 2021, të ardhurat në buxhet arritën në 510 miliardë lekë⁹

⁸ <http://instat.gov.al/al/temat/ekonomi-dhe-financ%C3%AB/llogarit%C3%AB-komb%C3%ABtare-gdp/#tab2>

⁹ <http://financa.gov.al/statistika-fiskale-mujore/>

(4.2 miliardë Euro)¹⁰, me një rritje prej 20% në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe 11.8% më shumë se periudha para-pandemisë e vitit 2019, një sinjal se ekonomia i ka tejkaluar nivelet e para-krizës.

Grafiku 2: Treguesit fiskalë të konsoliduar të buxhetit të shtetit, periudha 2020-2021




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Ecuria pozitive e të ardhurave buxhetore ka vijuar dhe në 4-mujorin e parë të vitit 2022, e ndihmuar nga rritja e çmimeve që ka shtuar të ardhurat nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar dhe përmirësimi i administrimit, pas zbatimit të sistemit të ri të fiskalizimit. Për periudhën janar - prill 2022, të ardhurat në buxhet ishin 188 miliardë lekë (1.5 miliardë Euro), me një rritje prej 23% në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Për shkak të rritjes së lartë të të ardhurave dhe frenimit të shpenzimeve, buxheti shënoi nivelin më të lartë të suficitit¹¹ të regjistruar ndonjëherë.

¹⁰ <http://financa.gov.al/statistika-fiskale-mujore/>

¹¹ Diferenca midis të ardhurave dhe shpenzimeve

Grafiku 3: Treguesit fiskalë të konsoliduar të buxhetit të shtetit, 4 M I, periudha 2011-2022



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Për të dytin vit radhazi në 2021-n, situata shëndetësore vijoi të ishte e rënduar, me një vdekshmëri të lartë shtesë¹², sidomos në pjesën e parë të vitit. Vala e dytë e pandemisë, që kulmoi në janar - mars 2021, shënoi rritje të lartë të fataliteteve në vend. Në vitin 2021, u raportuan 30,580 humbje jete gjithsej¹³, me një rritje prej 10.8% në raport me mesataren e 2016-2019 për të njëjtën periudhë.

Rritja më e lartë e vdekshmërisë shtesë u raportua në tremujorin e parë, me 65% më shumë në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2020, kur pandemia sapo kishte filluar, duke u ngadalësuar në 13.5% në tremujorin e dytë dhe u kthye në negative në dy tremujorët pasardhës, përkatësisht -3.3% dhe -16.6%, teksa pandemia filloi të lehtësohej. Megjithatë, në krahasim me mesataren e 2016-2019, vdekshmëria shtesë sipas tremujorëve shënoi rritje, nga 21% në tremujorin e dytë në 62% në të katërtin.

Në tremujorin e parë 2022, vdekshmëria shtesë ra me 22.3% në krahasim me të njëjtën periudhë të 2021, por ishte 15.7% më e lartë se mesatarja e 2016-2019.

¹² Vdekshmëria shtesë (excess death/mortality) është një term i përdorur në epidemiologji dhe shëndetin publik që i referohet numrit të vdekjeve nga të gjitha shkaqet gjatë një periudhe krize që është mbi dhe përtej asaj që do të pritej në kushte normale <https://ourworldindata.org/excess-mortality-COVID>

¹³ <http://instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/lindjet-vdekjet-dhe-martesat/publikimet/2021/treguesit-demografik%C3%AB-t3-2021/>


Për periudhën 2020-2021, vdekshmëria në vend është rritur me rreth 33.2% në krahasim me periudhën përkatëse të mesatares 2018-2019. Sipas të dhënave të Eurostat¹⁴ dhe statistikave rajonale, Shqipëria është e treta në Evropë për rritjen më të lartë të vdekshmërisë shtesë, pas Kosovës (38.1) dhe Maqedonisë së Veriut (35.1), shumë më e lartë sesa mesatarja në shtetet e tjera të Evropës, që varion midis 2-22% për periudhën e sipërpërmendur.

Shpenzimet për sektorin e shëndetësisë shënuan rritje të ndjeshme në vitin 2021, të ndikuara në pjesën e parë të vitit nga rritja e shtimeve në spital, si rrjedhojë e pandemisë, dhe në pjesën e dytë nga lëvrimi i kredisë së Bankës Botërore për përbalimin e pandemisë dhe fillimin e pagesave për koncesionin e laboratorëve.

Për vitin 2021, shpenzimet totale faktike për shëndetësinë ishin 78 miliardë lekë (642 milionë Euro), me një rritje prej 16% me bazë vjetore në krahasim me periudhën përkatëse 2020, ose 10.8 miliardë lekë (88 milionë Euro) më shumë.

Duke përjashtuar programet e “Përkujdesit Social” dhe “Rehabilitimin e të përndjekurve politikë”, që nuk janë të lidhura drejtpërdrejt me shëndetësinë, shpenzimet e dedikuara vetëm për shëndetësinë për vitin 2021 ishin 48 miliardë lekë (393 milionë Euro), me një rritje prej 27% në krahasim me vitin e mëparshëm.

Grafiku 4: Realizimi i shpenzimeve të buxhetit të shëndetësisë, sipas programeve të miratuara, 2018 - 2021




Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

¹⁴ https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/demo_r_mwk_ts/default/table?lang=en

Vetëm në 4-mujorin e tretë të vitit 2021, shpenzimet totale faktike për shëndetësinë ishin 29 miliardë lekë (240 milionë Euro), me një rritje prej 18.1% me bazë vjetore, ose 4.5 miliardë lekë (37 milionë Euro) më shumë. Duke përjashtuar programet e “Përkujdesit Social” dhe “Rehabilitimin e të përndjekurve politikë”, vetëm për shëndetësinë MSHMS shpenzoi 19 miliardë lekë (155 milionë Euro), me rritje 24%.

Grafiku 5: Realizimi i shpenzimeve të buxhetit sipas programeve të miratuara, shtator-dhjetor, 2020-2021




Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Pas lehtësimit të pandemisë, në katër mujorin e parë të vitit 2022, shpenzimet totale për shëndetësinë shfaqën rënie. Totali i shpenzimeve për periudhën janar - prill 2022 ishte 23.4 miliardë lekë (192 milionë Euro), me rënie 2.7% në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Duke përjashtuar programet e “Përkujdesit Social” dhe “Rehabilitimin e të përndjekurve politikë”, vetëm për shëndetësinë MSHMS shpenzoi 14.4 miliardë lekë (121 milionë Euro), me rënie 1.3%.

Grafiku 6: Realizimi i shpenzimeve të buxhetit të shëndetësisë, sipas programeve të miratuara, janar - prill 2019-2022



2. Realizimi i buxhetit total dhe programeve të MSHMS, viti 2021 dhe 4 M III 2021

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) administron dhe menaxhon fondet publike sipas shtatë programeve të miratuara, si vijon:

1. Planifikim, Menaxhim, Administrimi
2. Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor
3. Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor
4. Shërbime të Shëndetit Publik
5. Shërbimi Kombëtar i Urgjencës Mjekësore
6. Përkujdesi Social
7. Rehabilitimi i të Përndjekurve Politikë

Viti 2021

Për vitin 2021, shpenzimet totale faktike për shëndetësinë ishin 78 miliardë lekë (642 milionë Euro), me një rritje prej 16% me bazë vjetore në krahasim me periudhën përkatëse 2020, ose 10.8 miliardë lekë (88 milionë Euro) më shumë.


Duke përjashtuar programet e “Përkujdesit Social” dhe “Rehabilitimin e të përndjekurve politikë”, që nuk janë të lidhura drejtpërdrejt me shëndetësinë, shpenzimet e dedikuara vetëm për shëndetësinë për vitin 2021 ishin 49.2 miliardë lekë (393 milionë Euro), me një rritje prej 27% në krahasim me vitin e mëparshëm.

TABELA 1 : Realizimi i shpenzimeve të buxhetit të shëndetësisë, sipas programeve të miratuara, 2018-2021 (mln lekë)				
	2018	2019	2020	2021
Planifikim, Menaxhim, Administrim	450	337	2,188	1,534
Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor	8,500	7,814	7,702	8,422
Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor	7,179	25,400	25,732	31,939
Shërbimi Kombëtar i Urgjencës Mjekësore	435	180	296	290
Shërbime të Shëndetit Publik	2,635	2,674	2,842	7,016
TOTALI I SHPENZIMEVE TË LIDHURA DIREKT ME SHËNDETËSINË	19,199	36,406	38,761	49,200
Përkujdesi Social	21,893	23,539	27,756	28,216
Rehabilitimi i të përndjekurve politikë	1,027	1,229	1,033	945
TOTALI	42,119	61,173	67,550	78,361

Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Në totalin e buxhetit të MSHMS-së, për vitin 2021, peshën kryesore e zë programi “Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor”, me 40.7%, i ndjekur nga “Përkujdesi Social”, me 36% dhe “Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor”, me 10.7%.

Grafiku 7: Realizimi i shpenzimeve të buxhetit të shëndetësisë, sipas programeve të miratuara, janar - prill 2019-2022




Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Sipas zërave kryesorë të detajuar nga pesë programet direkte të shëndetësisë, “Planifikim, Menaxhim, Administrim”, “Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor”, “Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor”, “Shërbime të Shëndetit Publik” dhe “Shërbimi Kombëtar i Urgjencës Mjekësore” rritja e shpenzimeve të shëndetësisë për vitin 2021 është ndikuar nga:

- “Trajtimi i pacientëve të shtruar në spitale”, fondi për të cilin u rrit me 19.6%, ose 3.7 miliardë lekë (30.5 milionë Euro) më shumë.
- “Persona të vaksinuar me vaksinën anti-COVID”, është një zë i ri që u zbatua për herë të parë në vitin 2021, në kuadër të programit për vaksinimin kundër COVID-19, me një fond total për vitin 2021 prej 3.5 miliardë lekë (28.4 milionë Euro).
- Fillimi i projektit “Emergjenca COVID-19”, kredi e Bankës Botërore, nga i cili u disbursuan 1.6 miliardë lekë në vitin 2021 (13.4 milionë Euro).
- Fillimi i kontratës koncesionare e ofrimit të shërbimit të laboratorëve, me një disbursim total prej 1.1 miliardë lekësh (9 milionë Euro).

Grafiku 8: Realizimi i buxhetit të shëndetësisë, sipas produkteve kryesore, 2019-2021



Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Shtator - Dhjetor 2021

Në 4-mujorin e tretë të vitit 2021, shpenzimet totale faktike për shëndetësinë ishin 29.3 miliardë lekë (240 milionë Euro), me një rritje prej 18.1% me bazë vjetore, ose 4.5 miliardë lekë (37 milionë Euro) më shumë.

Duke përjashtuar programet e “Përkujdesit Social” dhe “Rehabilitimin e të përndjekurve politikë”, vetëm për shëndetësinë MSHMS shpenzoi 19 miliardë lekë (155 milionë Euro), me rritje 24%.

TABELA 2: Realizimi i shpenzimeve të buxhetit sipas programeve të miratuara, shtator-dhjetor, 2020-2021 (mln lek)		
	shtator - dhjetor 2020	Shtator - dhjetor 2021
Planifikim, Menaxhim, Administrim	1,082	1,264
Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor	2,156	2,531
Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor	10,782	13,119
Shërbime të Shëndetit Publik	1,136	1,953
Shërbimi Kombëtar i Urgjencës Mjekësore	181	148
Totali i shpenzimeve të lidhura direkt me shëndetësinë	15,337	19,015
Përkujdesi Social	9134.931	9815.858
Rehabilitimi i të përndjekurve politikë	323.47	457.199
TOTALI	24,796	29,288

Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

I. Planifikim, Menaxhim, Administrim

Ky program përfshin kryesisht shpenzimet për aktet ligjore e nënligjore të miratuara. Në dy vitet e fundit në këtë program janë shtuar edhe zërat për blerjen e materialeve mbrojtëse për COVID-19 dhe bonuset për mjekët dhe infermierët jashtë shtetit, në kuadër të COVID-19.

Shpenzimet për këtë program në periudhën shtator - dhjetor 2021 ishin 1.3 miliardë lekë (10.3 milionë Euro), me një rritje prej 17% në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

II. Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor


Programi i “Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor” ka si objektiv kryesor përmirësimin e shërbimeve parandaluese dhe të diagnostikimit të hershëm të sëmundjeve, si dhe plotësimin e qendrave shëndetësore në masën 80% me infrastrukturën e nevojshme për funksionimin e sistemit të informacionit.

Shpenzimet për këtë program ishin 2.5 miliardë lekë (20.7 milionë Euro) për periudhën shtator - dhjetor 2021, me një rritje prej 17.4% në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Rritja është ndikuar nga shtimi i buxhetit për “Pacientë të trajtuar me recetë me rimbursim nga mjeku i familjes”, me 60%.

Në të kundërt, shpenzimet për programin “Numri i vizitave në Kujdesin Shëndetësor Parësor” ranë me 14.4%, si rrjedhojë e lehtësimit të situatës së pandemisë në muajt e fundit të vitit 2021, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë, kur pandemia ishte në kulmin e saj.

Grafiku 9: Programi "Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor", sipas produkteve kryesore, shtator - dhjetor, 2020-2021



Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Në katër mujorin e fundit 2021 rifilluan shpenzimet për persona që përfitojnë check – up, i cili ishte ndërprerë gjatë pandemisë, duke filluar nga gjysma e dytë e muajit mars

2020. Për periudhën shtator - dhjetor 2021 u shpenzuan për herë të parë që pas ndërprerjes 146 milionë lekë (1.2 milionë Euro) për programin “Persona që përfitojnë check – up”.

III. Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor

Programi i “Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Dytësor” synon ofrimin gjithëpërfshirës të shërbimeve të kujdesit shëndetësor dytësor, trajtimin e pacientëve për përballimin e situatës së krijuar nga pandemia, si dhe trajtimin stimulues të personelit shëndetësor në vijën e parë në luftën ndaj pandemisë COVID-19.

Shpenzimet për shërbimet e kujdesit shëndetësor dytësor u rritën me 21.7% me bazë vjetore në shtator - dhjetor 2021, duke arritur në 13.1 miliardë lekë (107 milionë Euro).

Ndikimin kryesor në këtë rritje e dhanë dy programe të reja:

- **Kredia e Bankës Botërore për COVID-19.** Në vitin 2020 Banka Botërore miratoi projektin “Përgjigja ndaj emergjencës COVID-19 e Shqipërisë”,¹⁵ i cili u mbështet me 16.8 milionë Euro nga ky institucion në vitin 2020. Projekti përbëhet nga dy komponentë, ku i pari me një vlerë 16.25 milionë USD (rreth 16 milionë Euro) parashikon mbështetjen e sektorit shëndetësor në mënyrë të menjëhershme dhe në afatmesme, ndërkohë që 0.55 milionë USD janë parashikuar në komponentin e dytë që lidhet me menaxhimin e projektit. Projekti është zgjatur deri në fund të vitit 2022, nga qershori 2022 që ishte afati fillestar¹⁶. Në 4 muajt e fundit të vitit 2021, nga projekti u disbursuan 1.6 miliardë lekë (13.4 milionë Euro).

- **Ekzaminime Laboratorike.** Në vitin 2021 filloi zbatimi i koncesionit “Financimi, projektimi, rinovimi, pajisja, riorganizimi dhe funksionimi i Koncesionit/Partneritetit Publik Privat për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale, dhe atyre bashkiake të Sarandës e Lushnjës”, me vlerë totale kontrate prej 13 miliardë lekësh¹⁷ (105 milionë Euro), që u fitua nga kompania “Laboratory Network”¹⁸. Shuma e disbursuar në 4-mujorin e fundit të 2021 është 742 milionë lekë (6.1 milionë Euro).


¹⁵ <https://www.news24.al/bota/projekti-168-milione-euro-per-emergjencen-ndaj-covid-19-bb-behet-efektiv-ne-6330>

¹⁶ <https://www.monitor.al/ristrukturohet-projekti-per-covid-19-banka-boterore-e-shtyn-deri-ne-fund-te-vitit/>

¹⁷ <https://openprocurement.al/sq/hconcession/view/id/6>

¹⁸ <https://opencorporates.al/sq/nuis/L91923002T>

Grafiku 10: Programi "Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor", sipas produkteve kryesore, shtator-dhjetor, 2020-2021




Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

IV. Shërbime të Shëndetit Publik

Shërbimi i shëndetit publik ofrohet nëpërmjet programeve kombëtare të imunizimit, TBC, HIV/AIDS dhe Infeksionet Seksualisht të Transmetueshme (IST), të survejancës epidemiologjike dhe ndjekjes së sëmundshmërisë infektive (sëmundshmërisë kronike me pasoja në shëndetin publik të ndikuara nga kushtet e mjedisit), si dhe të programeve të sigurisë ushqimore, kontrollit të ujit të pijshëm dhe shëndetit riprodhues.

Shpenzimet faktike për programin e "Shërbime të Shëndetit Publik" ishin 1.9 miliardë lekë (16 milionë Euro) për 4-mujorin e fundit 2021, duke u rritur me 72% në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kjo rritje ka ardhur si rrjedhojë e shtimit në këtë program të vaksinave kundër COVID-19, që ka për qëllim imunizimin e popullatës. Shpenzimet për personat e vaksinuar me vaksinën anti-COVID në periudhën shtator-dhjetor 2021 rezultuan 672 milionë lekë (5.5 milionë Euro).

Grafiku 11: Programi "Shërbime të Shëndetit Publik", sipas produkteve kryesore, shtator-dhjetor, 2020-2021



Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

V. Shërbimi Kombëtar i Urgjencës Mjekësore

Ky program synon të zhvillojë shërbimin e urgjencës mjekësore si pjesë integrale të sistemit shëndetësor, të sigurojë ofrimin e ndihmës urgjente mjekësore në kohë dhe cilësi në të gjithë vendin, si dhe të rrisë vetëdijen e popullatës mbi përparësitë e përdorimit korrekt të shërbimit të urgjencës mjekësore.

Shpenzimet faktike për këtë program ishin 147 milionë lekë (1.2 milionë Euro), me një rënie prej 18.6% për zërin “raste të trajtuara nga njësitë e urgjencës mjekësore”.

3. Zbatimi i programeve, sipas zërave 4-mujori i parë 2022

Në 4-mujorin e parë të vitit 2022, totali i shpenzimeve totale për shëndetësinë ishte 23.4 miliardë lekë (192 milionë Euro), me rënie 2.7% në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Shpenzimet totale për shëndetësinë shfaqën rënie për herë të parë që nga fillimi i pandemisë, si rrjedhojë e lehtësimit të sëmundjes dhe uljes së ritmeve të vaksinimit.

Duke përjashtuar programet e “Përkujdesit Social” dhe “Rehabilitimin e të përndjekurve politikë”, vetëm për shëndetësinë MSHMS shpenzoi 14.8 miliardë lekë (121 milionë Euro), me rënie 1.3%.

TABELA 3: Realizimi i shpenzimeve të buxhetit të shëndetësisë, sipas programeve të miratuara, janar - prill 2019-2022 (mln lekë)				
	4 M 2019	4 M 2020	4 M 2021	4 M 2022
Planifikim, Menaxhim, Administrim	80	267	67	121
Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor	3,191	2,908.04	3,055	3,844
Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor	6,943	7,175	9,135	9,099
Shërbime të Shëndetit Publik	891	829	2,670	1,686
Shërbimi Kombëtar i Urgjencës Mjekësore	39	50	81	60
Totali i shpenzimeve të lidhura direkt me shëndetësinë	11,145	11,229	15,007	14,810
Përkujdesi Social	7,295	9,541	8,796	8,431
Rehabilitimi i të përndjekurve politike	423	432	270	173
TOTALI	18,863	21,202	24,073	23,413

Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

- Shpenzimet për programin “**Planifikim, Menaxhim, Administrim**” ishin 121 milionë lekë (gati 1 milion Euro) për 4-mujorin e parë 2022, me pothuajse dyfishim nga e njëjta periudhë e një viti më parë, të lidhura kryesisht me produktin “Akte ligjore e nënligjore të miratuara”.
- Shpenzimet për programin “**Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor**” ishin 3.8 miliardë lekë (31.5 milionë Euro) për 4-mujorin e parë 2022, me rritje prej 25.8% me bazë vjetore.


Rritja u ndikua nga shpenzimet për *“Pacientë të trajtuar me recetë me rimbursim nga mjeku i familjes”*, që ishin 78% më të larta se e njëjta periudhë e një viti më parë, të lidhura kryesisht me pagimin e detyrimeve të prapambetura.

Sipas raportit të monitorimit të Ministrisë së Shëndetësisë, “Për 4 mujorin e I-rë të vitin 2022, sipas analizës statistikore të vlerave të pranura të rimbursimit të barnave, janë pranuar listë-tregues në vlerën 3.9 miliardë lekë (31 milionë Euro), ose 4.5% më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Gjatë periudhës së raportimit u paguan detyrimet të vitit të kaluar në vlerën 1 miliard lekë (8.1 milionë Euro), nga të cilat 433 milionë lekë (3.5 milionë Euro) rimbursim i muajit nëntor 2021 dhe 597 milionë lekë (4.9 milionë Euro) rimbursim i muajit dhjetor 2021. Numri i pacientëve që kanë përfituar nga lista e barnave të rimbursuara është 341,347 persona, ose 4,457 pacientë më pak nga një vit më parë”.

Fondi për produktin *“Numri i vizitave në Kujdesin Shëndetësor Parësor”* ra me 26.3% në 4-mujorin e parë, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Sipas raportit të monitorimit “Personeli i qendrave shëndetësore, është angazhuar maksimalisht për ofrimin e shërbimit ndaj popullatës edhe në kushtet e vështira të shkaktuara nga pandemia, nëpërmjet konsultave e vizitave, në qendra e në distancë. Gjatë 4 mujorin e I-rë të vitin 2022, në qendrat shëndetësore të kujdesit parësor të financuara nga Fondi janë realizuar 2,463,032 vizita, me një rritje me 18.468 vizita më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2021”.

Produkti *“Persona që përfitojnë check-up”* u realizua me 150 milionë lekë (1.1 milionë Euro) për periudhën janar - prill 2022. Për 4-mujorin e I-rë të vitit 2022 veprimtaria lidhur me financimin e kontratës koncensionare të kontrollit bazë për popullsinë nga 35 - 70 vjeç nuk ka pasur ndërprerje. Kjo kontratë është ndërprerë që nga shtatori 2020 për arsye të situatës së krijuar nga pandemia dhe ka rifilluar në shtator 2021. Për periudhën e raportimit janë kryer 150,784 check-up.

Grafiku 13: Programi "Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor", sipas produkteve kryesore, janar - prill, 2021-2022




Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

→ Shpenzimet për programin **“Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor”** ishin 9.1 miliardë lekë (75 milionë Euro) për 4 mujorin e parë të vitit, pothuajse në të njëjtin nivel me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Fondi për “Trajtimin e pacientëve të shtruar në spitale”, që zë gati 90% të shpenzimeve totale për këtë program, ra me 11% me bazë vjetore për 4-mujorin e parë 2022. Sipas raportit të monitorimit, “Spitalet publike janë financuar gjithsej në shumën 7.7 miliardë lekë (63 milionë Euro), ose 32% e fondeve vjetore. Numri i personave të shtruar në spitalet e financuara nga Fondi për periudhën katër mujore është 86,392 pacientë, ose 12 836 pacientë më shumë nga e njëjta periudhë e vitit të kaluar”.

Për kontratën koncensionare të ofrimit të shërbimit të laboratorëve janë kryer pagesa për shumën prej 358 milionë lekë (3 milionë Euro), nga 1.57 miliardë lekë (13 milionë Euro) që është plani vjetor.

Grafiku 14: Programi "Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor", sipas produkteve kryesore, janar - prill, 2021-2022




Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

→ Shpenzimet për Programin "**Shërbime të Shëndetit Publik**" rezultuan 1.7 miliardë lekë për 4-mujorin e parë 2022, me rënie 37% me bazë vjetore. Reduktimi erdhi për shkak të rënies me 91% të fondit për "Persona të vaksinuar me vaksinën anti-COVID", pas lehtësimit të situatës pandemike dhe vaksinimit të pjesës më të madhe të popullsisë në vitin 2021.

Sipas raportit të Ministrisë së Shëndetësisë, gjatë periudhës janar - prill 2022 me vaksinën anti-COVID janë vaksinuar:

- Me doza të para 75.290 persona
- Me doza të dyta 129.614 persona
- Me doza të treta 129.276 persona

Grafiku 15: Programi "Shërbime të Shëndetit Publik", sipas produkteve kryesore, janar-prill, 2021-2022



Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

4. Vdekshmëria shtesë për vitin 2021 dhe T I 2022

Në vitin e dytë të pandemisë, vdekshmëria shtesë¹⁹ në vend vijoi të ishte e lartë, sidomos në tremujorin e parë të 2021-it, që përkon me valën e dytë të fortë të pandemisë, pas asaj të tetor - dhjetor 2020.


Për vitin 2021, në vend u regjistruan 30,580 vdekje,²⁰ me një rritje prej 10.8% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2020, kur vendi u përball me valën e parë të pandemisë.

Në raport me mesataren 2016-2019, periudhë që merret si referencë për krahasimin e vdekshmërisë shtesë të shkaktuar nga pandemia, rritja arrin në rreth 40%.

¹⁹ Vdekshmëria shtesë (excess death/mortality) është një term i përdorur në epidemiologji dhe shëndetin publik që i referohet numrit të vdekjeve nga të gjitha shkaqet gjatë një periudhe krize që është mbi dhe përtej asaj që do të pritej në kushte normale <https://ourworldindata.org/excess-mortality-COVID>

²⁰ <http://instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/lindjet-vdekjet-dhe-martesat/publikimet/2021/treguesit-demografik%C3%AB-t4-2021/>


Grafiku 16: Vdekjet, (nr.) periudha 2011-2021



Burimi: INSTAT

Sipas tremujorëve, rritja e vdekshmërisë shtesë për vitin 2021 erdhi si rrjedhojë e fataliteteve të larta që u shënuan në tremujorin e parë të vitit, kur u raportuan 10,222 humbje jete gjithsej, me një rritje prej 61.3% në raport me mesataren e 2016-2019 për të njëjtën periudhë. Në tremujorin e mëparshëm, tetor - dhjetor 2020, që përkon me valën e parë të fortë të pandemisë, ishin regjistruar 9,397 humbje jete gjithsej, me rritje 70% në krahasim me mesataren e të njëjtës periudhë 2016-2019. Pas marsit 2021, vala e pandemisë filloi të lehtësohej, por numri i vdekjeve vijoi të mbetej më i lartë në krahasim me mesataren e para pandemisë, përkatësisht +21.3% në tremujorin e dytë 2021, +29.6% në tremujorin e tretë 2021 dhe +42% në tremujorin e katërt 2021, (ndonëse në raport me tremujorin e katërt 2020, vdekjet shtesë ranë me 16.6%)

Grafiku 17: Vdekjet sipas tremujorëve (nr.)



Burimi: INSTAT


Edhe përgjatë vitit 2021, Shqipëria vijoi të ishte një nga vendet me rritjen më të lartë të vdekshmërisë shtesë në Evropë. Në dy vitet e pandemisë, 2020-2021, Shqipëria kishte rritjen e tretë më të lartë kumulative të vdekjeve në Evropë (+33.2), në krahasim me mesataren dy vjeçare 2016-2019, kur nuk kishte filluar ende pandemia, pas Kosovës (+38.1%) dhe Maqedonisë së Veriut (55.1%), sipas të dhënave të Eurostat²¹ dhe raporteve statistikore të Maqedonisë së Veriut²² dhe Kosovës²³.

²¹ https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/demo_r_mwk_ts/default/table?lang=en

²² <https://www.stat.gov.mk/publikacii/2021/Bilten%2012%20ANG.pdf>

²³ <https://ask.rks-gov.net/media/6485/buletini-tremujor-tm3-2021-tetori.pdf>

Grafiku 18: Rritja e vdekshmërisë 2020-2021, kundrejt mesatares 2016-2019 (%), Evropa




Burimi: Eurostat, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Zyra Statistikore e Maqedonisë së Veriut, përpunime të Autorëve.

Në tremujorin e parë të vitit 2022, vdekshmëria shtesë ka vijuar të jetë më e lartë sesa periodha e para pandemisë, por ka shënuar rënie në raport me valët kulmuese të pandemisë në dy vitet e mëparshme. Në janar - mars 2022, në vend u shënuan gjithsej

7,938 vdekje²⁴. Në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë, kur pandemia kulmoi dhe u regjistrua niveli më i lartë rekord i vdekjeve në historinë e Shqipërisë, numri është 22.3% më i ulët.

Por, në raport me mesataren 2016-2019 të janar - mars, kur vendi ishte në periudhë normale, fatalitetet janë rritur me 25.3%, në një tregues që pandemia vijon të vrasë, por edhe të pasojave që ka lënë te popullata që e ka kaluar COVID-19, duke përshpejtuar rastet fatale.

Grafiku 19: Vdekjet sipas tremujorëve në pandemi 2020-2021, krahasuar me mesataren 2016-2019 (nr)



²⁴ <http://instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/lindjet-vdekjet-dhe-martesat/publikimet/2022/treguesit-demografik%C3%AB-t1-2022/>

5. Ecuria e procesit të vaksinimit

Ritmet e vaksinimit u përshpejtuan ndjeshëm në gjysmën e dytë të vitit 2021, ndërsa ritmet e tij u ngadalësuan ndjeshëm në tremujorin e parë 2022.

Deri në fund të vitit 2021, Shqipëria kishte 2,396,863 vaksinime anti-COVID²⁵. Nga dozat e vaksinës anti-COVID, të kryera në Shqipëri ishin: 1,147,753 doza të para, 1,040,493 doza të dyta dhe 147,507 doza të treta. E vaksinuar me të paktën me një dozë ishte rreth 41% e popullsisë.

Vaksinimi ka vijuar me ritme më të ngadalta edhe në muajt e parë të vitit 2022. Deri në fund të muajit prill 2022 ishin kryer 2,814,626 vaksinime gjithsej²⁶. E vaksinuar me të paktën me një dozë ishte rreth 46% e popullsisë (1,293,234 doza të para) deri në fund të muajit prill 2022.

Shqipëria mbetet ndër të fundit në Evropë sa i përket vaksinimit, në raport me popullatën. Deri në 10 korrik 2022, Shqipëria kishte vaksinuar plotësisht 44%²⁷ të popullsisë, nga 66% që ishte mesatarja e Evropës për të njëjtën periudhë dhe 61% mesatarja globale.

6. Pasojat afatgjata të COVID-19 në shëndetin e popullatës

Ndonëse pandemia e COVID-19 është lehtësuar që nga fundi i vitit 2021 dhe vala e konstatuar në pjesën e deritanishme të vitit 2022 është më e lehtë, pasojat afatgjata të pandemisë vijojnë të ndihen dhe parashikohet të dëmtojnë popullatën dhe në afatin e mesëm. Shumë të prekur po vuajnë “COVID-in e gjatë”, ndërsa do të duhet të përballojnë dhe prekjen për herë të dytë nga pandemia. Ata po vuajnë nga pasojat direkte dhe indirekte të sëmundjes, të tilla si dëmtime të mushkërive, lodhje kronike dhe dëmtim të sistemit nervor dhe çrregullime psikike. Pasoja të tilla zgjasin 4-5 muaj, por edhe më shumë pas kalimit të infeksionit dhe po cilësohen nga sistemet shëndetësore si sindromi “post-COVID”, ose “COVID i zgjatur”.

Në 2021, periudhë në të cilën kulmoi pandemia nga COVID-19, në spitalet publike numri i pacientëve të shtruar u rrit 17% më shumë se 2020. Nga 220,325 pacientë të

²⁵ <https://shendetesia.gov.al/vaksinimi-anticovid-2396863-vaksinime/>

²⁶ <https://shendetesia.gov.al/vaksinimi-anticovid-2814626-vaksinime/>

²⁷ <https://ourworldindata.org/covid-vaccinations>

shtruar në spitale në 2020, vitin e kaluar u shtruan 257,829 pacientë, sipas treguesve të monitorimit të Ministrisë së Shëndetësisë.

Në 2021 ka pasur shtim të rasteve të trajtuara me sëmundje kardiologjike, 25% më shumë se 2020. Nga 6,197 pacientë të trajtuar në 2020, në 2021 numri i tyre arriti në 7,756 pacientë të trajtuar nga paketat e kardiologjisë dhe kardiokirurgjisë. Shtim ka pasur edhe për pacientët e trajtuar me radioterapi. Në 2021 numri i tyre u rrit 20% më shumë në raport me 2020.

Mjekët parashikojnë se do të këtë edhe këtë vit shtim të rritjeve të rasteve të sëmundjeve kardiake, sëmundjeve tumorale, sëmundjeve metabolike e të tjera, edhe pas epidemisë së COVID-19²⁸. Në shumicën e individëve që kalojnë infeksionin viral, shfaqen çrregullime në koagulimin e gjakut, endotelin e enëve të qarkullimit të gjakut, metabolizmin e yndyrave, sheqernave etj, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi në shëndetin e zemrës dhe të enëve të gjakut. Kjo sjell pasojë rritjen në numër të pacientëve kardiakë e jo vetëm.

²⁸ Intervistë me mjekun e urgjencës, Ilir Allkja

7. Konkluzione

Shpenzimet për shëndetësinë kanë shënuar rritje të ndjeshme në vitin 2021, të detyruara nga situata emergjente për shkak të nevojës për të vaksinuar popullatën dhe përballimin e shpenzimeve për trajtimin e të shtruarve në spitale.

Por, vëmendja për shëndetësinë rezulton të ketë rënë në muajt e parë të këtij viti, pasi shpenzimet për këtë sektor erdhën në rënie, ndonëse buxheti arkëtoi të ardhura rekord për shkak të efektit të shtrenjtimit të çmimeve.

Pasojat direkte të pandemisë në shëndetin e personave që e kanë kaluar atë, si dhe vonesat në trajtimin e diagnostikimin e sëmundjeve të tjera për shkak të karantinës, kanë ndikuar në rritjen e barrës së sëmundshmërisë në vend për vitin 2021.

Sistemi shëndetësor do të vuajë pasojat e “COVID-it të zgjatur”, çka do të ndikojë në rritjen e barrës së të sëmurëve kronikë në vijim. Kjo tendencë po konstatohet dhe në vitin 2022 dhe pritet të vijojë dhe në të ardhmen afatmesme.

Ndërsa vala e COVID-19 nuk rezulton të ketë kaluar dhe është riaktivizuar sërish përgjatë vitit 2022, Shqipëria mbetet ndër të fundit në Evropë sa i përket vaksinimit përgjatë gjithë vitit 2021 dhe ecurisë në 2022, në raport me popullatën. Deri në datën 10 korrik, vetëm 44% e popullsisë është vaksinuar plotësisht, nga 61% që është mesatarja globale.

8. Rekomandime

Edhe pse vala aktuale e pandemisë është më e lehtë në krahasim me periudhën 2020-2021, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk duhet të ulë vëmendjen dhe duhet të përqendrojë burimet dhe përpjekjet për të ofruar kujdes më të mirë shëndetësor, me kosto të përgjithshme më të ulët dhe të jetë e përgatitur për valët e ardhshme të COVID-19, apo edhe pandemi të tjera të mundshme.

Pandemia dhe shtimi i barrës së sëmundshmërisë në vend kanë rritur nevojën për më shumë shpenzime në kujdesin shëndetësor, e për rrjedhojë edhe për një fokus më të qartë të orientimit të fondeve publike.

Shpenzimet për shëndetësinë në raport me PBB-në, që historikisht janë luhatur në rreth 3% të PBB-së, duhet të rriten gradualisht të paktën me 2 pikë përqindje, duke arritur në 5% të PBB-së.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe institucionet e varësisë duhet të përgatiten për një valë të re të pandemisë, si dhe të shtojnë përpjekjet për edukimin e popullatës në kuadër të procesit të vaksinimit.

Nëse do të ketë një valë më të fortë në periudhën e vjeshtës dhe dimrit, zbatimi i masave të distancimit publik do të jetë pothuajse i pamundur, ndaj është thelbësore që institucionet shëndetësore, sidomos spitalet dhe personeli shëndetësor të jenë të përgatitur për të përballuar një valë të mundshme të shtuar në muajt në vijim.

Muajt e fundit, vëmendja e qeverisë është përqendruar në përballimin e krizës që po shkakton në ekonomi rritja e fortë e çmimeve (inflacioni në prill arriti në 6.2%). Rritja e çmimeve të energjisë dhe mungesa e reshjeve pritet që të rrisin presionin mbi financat publike në muajt e ardhshëm, duke hequr vëmendjen nga emergjenca shëndetësore. Në këtë situatë, është e rëndësishme që buxheti të mos e heqë vëmendjen nga shëndetësia dhe të mbajë kontigjenca të mjaftueshme për t'u përballur me një valë të re të mundshme pandemike në gjysmën e dytë të vitit.

PJESA 2

Rimbursimi i paktës anti-COVID, 2021, janar – prill 2022

Gjetjet kryesore

Nga nëntori 2020 deri në prill 2022, nga fondi total 1,2 miliardë lekë (9.4 milionë Euro) në dispozicion për paketën e rimbursimit anti-COVID-19 në banesë, u përfituan nga pacientët vetëm rreth 37.8 milionë lekë ose 3% e fondit të dhënë në dispozicion.²⁹ Gjithsej kanë përfituar rreth 9000 persona ose 3.2% e infektiveve zyrtare të deklaruara në vendin tonë deri më 30 prill 2022.

Vendimi për paketën e rimbursimit anti-COVID-19 u hartua nga qeveria duke marrë në konsideratë nevojat për trajtim për rreth 600 pacientë të konfirmuar pozitiv në ditë, ose rreth 36,000 pacientë për dy muaj, 60% e të cilëve u parashikua të trajtohen me skemën e formave të lehta dhe 40% të trajtohen me skemën e formave të moderuara³⁰. Nga nëntori në dhjetor të vitit 2020, përfituan rimbursim vetëm 1708 persona të infektuar nga COVID-19, me një shumë 6,3 milionë lekësh (52 000 euro).

Nga janari në dhjetor 2021, përfituan nga paketa e rimbursimit për të sëmurët me COVID-19 rreth 6534 persona, me një shumë të përfituar rreth 28,1 milionë lekë (230 mijë Euro). Ndarë në katër mujorë, përfituesit ishin të përqendruar në 4-mujorin e parë me 5,475 persona, ndaj të cilëve u nda një shumë prej rreth 23 milionë lekësh (188 000 Euro). Në 4-mujorin e tretë të vitit shtator - dhjetor 2021 përfituan rreth 863 persona, me një shumë prej 4,6 milionë lekësh (37 000 Euro).³¹

Për 4-mujorin e parë të vitit 2022, numri i pacientëve që kanë përfituar nga lista e barnave të rimbursuara është 341,347 persona, ndërsa personat që kanë përfituar paketën anti-COVID-19 janë 678 ose 4,797 pacientë më pak nga e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Ndaj të 678 personave që përfituan nga paketa anti-COVID-19 u shpërndanë rreth 3 milionë lekë (25 000 Euro)³².

Në total, nga nëntori i vitit 2020 deri në prill 2022, kanë përfituar nga paketa anti-COVID 8920 persona për një shumë totale prej 37.6 milionë lekësh (308 000 Euro), që përbën

²⁹ <https://shendetesia.gov.al/tabelat-e-raportimit-per-intervalet-kohore-3-muaj-9-muaj-dhe-vjetore-si-dhe-relacionet-perkatese/>

³⁰ <https://panel.klsh.org.al/storage/phpybUmL6.pdf>

³¹ <https://shendetesia.gov.al/tabelat-e-raportimit-per-intervalet-kohore-3-muaj-9-muaj-dhe-vjetore-si-dhe-relacionet-perkatese/>

³² Raporti i Monitorimit, 3-mujori I 2022, në Ministrinë e Shëndetësisë

vetëm 3.1% të shumës së vënë në dispozicion për paketën e rimbursimit anti-COVID-19 në banesë.

TABELA 4: Rimbursimi i pacientëve që kanë përfituar nga paketa anti-COVID, nëntor 2020 - prill 2022		
	<i>Numri i pacientëve që kanë përfituar rimbursim anti-COVID</i>	Vlera (LEK)
Nëntor - dhjetor 2020	1,708	6,300,000
Viti 2021	6,534	28,100,000
Janar - prill 2022	678	3,000,000
TOTALI	8,920	37,400,000

Shpenzimet e kurimit për një person të infektuar me COVID-19 përgjatë dy viteve të pandemisë ishin me vlera shumë të larta në shumë raste. Ka persona që kanë blerë mjekime që kanë kaluar vlerën e 6000 Eurove për trajtim në shtëpi. Përveç medikamenteve, shpenzimet më të larta ishin për disa mjekime kontrabandë, të tilla si Remdisivir. Shpenzimet mesatare për një të sëmurë më simptoma të lehta kanë arritur edhe në 1000 Euro, ku kryesisht kanë kushtuar ekzaminimet analizat e gjakut, një skaner për verifikimin e pasojave, trajtime me vitamina etj, ndërsa për ato me simptoma të moderuara kanë harxhuar deri në 6000 Euro për trajtim në shtëpi. Të tjerë që janë kuruar në spitalet private dhe në Turqi kanë shpenzuar shuma deri në 100,000 Euro.³³

Në vitin 2020, familjet shqiptare i rritën shpenzimet për shëndetësinë me 28%, ndërsa në Bashkimin Europian ky tregues ra me rreth 4%. Në këtë mënyrë Shqipëria shënoi rritjen më të lartë të shpenzimeve për shëndetin në Europë, e matur me ndryshimin vjetor të konsumit final të njësive ekonomike familjare (me çmime korente).

1. Përmbledhje ekzekutive

Pandemia COVID-19 që kur nisi në pranverë të vitit 2020 vuri në vështirësi fillimisht sistemet shëndetësore në të gjithë botën, duke sjellë njëkohësisht një krizë shëndetësore dhe ekonomike. Përgjatë dy viteve të pandemisë njerëzit kudo në botë

³³ Të dhëna me fokus grupe, tre farmacistë, tre mjekë dhe tre pacientë

janë përballur me pasojat shëndetësore të infektimit, që shpesh kanë prodhuar kosto të larta kurimi³⁴.

Njerëzit e infektuar u përballën me pasoja shëndetësore edhe pasi kaluan infektimin, duke shfaqur nevoja për mjekime afatgjata.³⁵

Studimet tregojnë se kostot e trajtimit të COVID-19 ishin të larta në të gjithë botën, por në vendet në zhvillim faturat financiare me të cilat u përballën të sëmurët ishin edhe më të larta si rrjedhojë e sistemeve të dobëta publike të sigurimeve.³⁶

Në Shqipëri rasti i parë i njohur me COVID-19 ishte me 9 mars 2020. Që nga ajo kohë deri në fund të prillit 2022 janë infektuar zyrtarisht rreth 275 000 persona³⁷.

Në nëntor të vitit 2020, qeveria miratoi një vendim të posaçëm me të cilin vendosi të rimbursojë shpenzimet e të infektuarve që u kuruan jashtë spitaleve.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 908, datë 18.11.2020, "Për miratimin e paketës së trajtimit anti-COVID-19 ambulator në banesë" përcaktoi që personat e testuar pozitiv me Sars Cov-2, përfitojnë pa pagesë trajtimin ambulator në banesë. Fondi total i parashikuar ishte 1.2 miliardë lekë (9.4 milionë Euro).³⁸

Rimbursimi përfshiu 2 terapitë e mjekimit, atë të fazës së lehtë, që shoqërohet vetëm me vitamina me vlerë 1700 lekë (13.8 Euro) dhe atë të fazës së mesme, që përfshin vitaminat dhe antibiotikët në rastet kur i prekuri ka vatra pulmonari me vlerë 10,900 lekë (89 Euro).

Nga nëntori 2020 deri në prill 2022, nga fondi total në dispozicion më paketën e rimbursimit në banesë të anti-COVID-19 (rreth 1,2 miliardë lekë), u përfituan nga pacientët vetëm rreth 37.6 milionë lekë (308 000 Euro) ose vetëm 3% e fondit të dhënë në dispozicion.³⁹ Gjithsej kanë përfituar rreth 9000 persona ose 3.2% e infektimeve zyrtare të deklaruara në vendin tonë deri me 30 prill 2022.

Interesi i qytetarëve për të përfituar nga paketa e rimbursimit ishte i ulët, pasi një sërë procedurash duheshin plotësuar për të përfituar një shumë të vogël.⁴⁰ Nga ana tjetër, të dhënat nga farmacistët pohuan se trajtimet në banesë për të sëmurët me simptoma të moderuara kanë arritur edhe në 2 deri në 6 mijë Euro.⁴¹

³⁴ <https://jamanetwork.com/journals/jamanetworkopen/fullarticle/2785079>

³⁵ https://www.who.int/publications/i/item/WHO-2019-nCoV-Post_COVID-19_condition-Clinical_case_definition-2021.1

³⁶ <https://www.nature.com/articles/s41598-021-97259-7>

³⁷ <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/11/18/908/c555fdc8-bd94-45fa-8739-b975a194d17e>

³⁸ <https://panel.klsh.org.al/storage/phpybUmL6.pdf>

³⁹ <https://shendetesia.gov.al/tabelat-e-raportimit-per-intervalet-kohore-3-muaj-9-muaj-dhe-vjetore-si-dhe-relacionet-perkatese/>

⁴⁰ Fokus grup me katër mjekës specialitë të Poliklinika e Specilizuar e Mushkërivë në Tiranë "Hektor Çoçoli"

⁴¹ Fokus grup me farmacistë (Në rrugën 5-Maji, Siri Kodra dhe Sulejman Delvina)


Pacientë të tjerë që janë kuruar jashtë vendit, kryesisht në spitalet e Turqisë, kanë përballuar nga xhepi shpenzime që kanë arritur deri në 100 000 Euro për person.⁴²

2. Efektiviteti i paketës financiare për të sëmurët me COVID-19 me 2020

Vendimi i qeverisë datë 18.11.2020 "Për miratimin e paketës së trajtimit anti-COVID-19 ambulator në banesë", përcaktoi një fond prej 1,2 miliardë lekësh, që do të shpërndahej deri në fund të vitit 2020.

Referuar të dhënave zyrtare, vendimi u hartua duke marrë në konsideratë nevojat për trajtim, llogaritur për rreth 600 pacientë të konfirmuar pozitiv në ditë ose rreth 36,000 pacientë për dy muaj, 60% e të cilëve u parashikua të trajtohen me skemën e formave të lehta dhe 40% të trajtohen me skemën e formave të moderuara⁴³. Nga nëntori në dhjetor të vitit 2020, përfituan rimbursim vetëm 1708 persona të infektuar nga COVID-19, me një shumë 6,3 milionë lekësh (52 000 euro).

Grafiku 20: Parashikimi dhe ecuria e përfituesve nga paketa anti-COVID në vitin 2020




Burimi: Ministria e Shëndetësisë, Raportet e Monitorimit, FDSKSH dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit

⁴² Fokus grupe me pacientë që janë kuruar në Turqi

⁴³ <https://panel.klsh.org.al/storage/phpybUmL6.pdf>

Grafiku 21: Ecuria e rimbursimit të fondeve për të sëmurët me COVID-19



Burimi: Ministria e Shëndetësisë, Raportet e Monitorimit, FSDKSH dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit

Për shkak të ecurisë së dobët të paketës së dedikuar për rimbursimin, paketa prej 1,2 miliardë lekë u mbart edhe për vitin 2021 dhe deri në përfundimin e saj.

3. Rimbursimi për të sëmurët me COVID-19 në vitin 2021

Nga janari në dhjetor 2021, përfituan nga paketa e rimbursimit për të sëmurët me COVID-19 rreth 6534 persona, me një shumë të përfituar rreth 28,1 milionë lekë (230 mijë Euro). Ndarë në 4-mujorë, përfituesit ishin të përqendruar në 4-mujorin e parë me 5475 persona, ndaj të cilëve u nda një shumë prej rreth 23 milionë lekësh (188 mijë Euro).

Në 4-mujorin e tretë të vitit shtator - dhjetor 2021 përfituan rreth 863 persona, me një shumë prej 4,6 milionë lekësh (38 000 Euro)⁴⁴.

⁴⁴ <https://shendetesia.gov.al/tabelat-e-raportimit-per-intervalet-kohore-3-muaj-9-muaj-dhe-vjetore-si-dhe-relacionet-perkatese/>

“Për vitin 2021, sipas analizës statistikore, vlera e pranuar e rimbursimit total të barnave ishte rreth 11 miliardë lekë (90 milionë Euro), nga të cilat 28.1 milionë lekë (230 mijë Euro) i përkasin vlerës së pranuar të listë-treguesve të paketës anti-COVID-19”, thuhet në raportin e monitorimit të Ministrisë së Shëndetësisë. Nga vlera totale e rimbursuar për medikamente me 2021, vetëm 0.2% shkuan për paketën e të sëmurëve me COVID-19⁴⁵.

Në gusht 2021 hyri në fuqi Lista e re e Barnave të Rimbursueshme, e cila përmban 1.191 alternativa tregtare ose 340 principe aktive. Nga lista e barnave të rimbursueshme kanë përfituar 409,773 persona, ndërkohë vetëm 1% për paketën anti-COVID (6534 persona)⁴⁶.

4. Rimbursimi për të sëmurët me COVID-19 për periudhën janar-prill 2022

Fillimi i vitit 2022 e gjeti vendin tonë në përmbyllje të vitit të dytë të pandemisë. Në muajt janar – shkurt, një valë e madhe infektimesh, krijuar nga varianti Omicron i COVID-19, u përhap në vend. Të dhënat zyrtare tregojnë se në janar-prill 2022 përfituan rimbursim 678 të infektuar me COVID-19, me një shumë prej rreth 3 milionë lekë.

Nga nëntori 2020 deri në prill 2022, kanë përfituar rimbursim nga paketa anti-COVID-19 rreth 9000 persona, me rreth 37,4 milionë lekë (306 000 Euro) nga rreth 1,2 miliardë (9.4 milionë Euro) lekë që ishte fondi në dispozicion⁴⁷.


“Për 4-mujorin e parë 2022, sipas analizës statistikore të vlerave të pranuar të rimbursimit të barnave, gjithsej janë rimbursuar 3.9 miliardë lekë, ose 183.6 milionë lekë (4.5%) më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Numri i pacientëve që kanë përfituar nga lista e barnave të rimbursuara është 341,347 persona, ndërsa personat që kanë përfituar paketën anti-COVID janë 678, ose 4797 pacientë më pak nga e njëjta periudhë e vitit të kaluar”, thuhet në raportin e monitorimit të Ministrisë së Shëndetësisë.

⁴⁵ <https://shendetesia.gov.al/tabelat-e-raportimit-per-intervalet-kohore-3-muaj-9-muaj-dhe-vjetore-si-dhe-relacionet-perkatese/>, përlogaritje Autori

⁴⁶ <https://shendetesia.gov.al/tabelat-e-raportimit-per-intervalet-kohore-3-muaj-9-muaj-dhe-vjetore-si-dhe-relacionet-perkatese/>

⁴⁷ Raportet e Monitorimit 4-mujore të Ministrisë së Shëndetësisë në periudhën 2021-2022

Grafiku 22: Personat përfitues dhe shuma e shpërndarë (në lek) nga paketa anti-COVID



Raportet e monitorimit 4-mujorë të Ministrisë së Shëndetësisë në periudhën 2021-2022

5. Përlllogaritja e kostove të rimbursimit në paketën anti-COVID

Në zbatim të vendimit të Këshillit Administrativ të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH) nr. 17, datë 30.10.2020, "Për krijimin e komisionit teknik për llogaritjen e kostos së paketës së trajtimit anti-COVID-19 ambulator në banesë", u ngrit Komisioni Teknik.

Komisioni teknik llogariti koston për paketën e trajtimit anti-COVID ambulator në banesë, të hartuar nga komiteti teknik i ekspertëve, ardhur në Fond Nr. 7816/5 prot., datë 30.10.2020, miratuar me urdhrin Nr. 579, datë 14.10.2020 "Për miratimin e udhëzuesit mbi ndjekjen në shtëpi të rasteve me infeksion COVID-19" të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Komisioni Teknik vlerësoi koston për paketën e trajtimit anti-COVID në bazë të udhëzuesve të miratuar për skemat e trajtimit, çmimeve të Listës së Barnave të Rimbursuara (LBR) në fuqi, çmimeve CIF 2020 për barnat jashtë listës së barnave të rimbursuara, duke shtuar marzhet e fitimit për rrjetin e hapur farmaceutik të pacaktuara në VKM Nr. 143 datë 18.02.2015.

Referuar të dhënave, nevojat për trajtim ishin për rreth 600 pacientë të konfirmuar pozitivë në ditë, ose rreth 36,000 pacientë për dy muaj, ku 60% e të cilëve parashikohet të trajtohen me skemën e simptomave të moderuara dhe 40% të trajtohen me skemën e formave të moderuara⁴⁸.

Në llogaritjen e kostove është ndjekur procedura si më poshtë:

- Skema e trajtimit mjekësor e përcaktuar në udhëzues.
- Kostot e medikamenteve që përdoren pjesë e LBR, u mor çmimi i miratuar me VKM.
- Për barnat jashtë LBR u mor çmimi CIF 2020 i miratuar, i ardhur zyrtarisht, duke shtuar marzhet e fitimit për rrjetin e hapur farmaceutik të përcaktuar në VKM Nr. 143 datë 18.02.2015.

Komisioni llogariti dy paketa të trajtimit anti-COVID ambulator:

- 1- Paketa e trajtimit të formave të lehta.
- 2- Paketa e trajtimit të formave të moderuara.

Kostoja e trajtimit të formave të lehta është sipas tabelës së më poshtme:

Nr.	Principi aktiv	Formë doza	Njësia	Sasia	Çmimi/njësi	Vlera	LBR
1	Azithromycine	250 mg	f.e.tabl.	8	38.73	309.84	Është në LBR
2	Levofloxacin	500 mg	f.e.tabl.	7	91.8	642.60	Nuk është në LBR
3	Paracetamol	500 mg	tablet	16	6.16	98.56	Nuk është në LBR
4	Vitamin C	100 mg	tablet	140	3.33	466.20	Nuk është në LBR
5	Vitamin D	10000 u.i	tablet	30	24.43	732.90	Është në LBR
6	Ibuprofen	400 mg	f.e.tabl.	8	5.13	41.04	Është në LBR
Vlera totale						1,648.54	

⁴⁸ <https://panel.klsh.org.al/storage/phpybUmL6.pdf>

Kostoja e trajtimit të formave të moderuara është sipas tabelës së më poshtme:

Nr.	Principi aktiv	Formë doza	Njësia	Sasia	Çmimi/njësi	Vlera	LBR
1	Azithromycine	250 mg	f.e.tabl.	8	38.73	309.84	Është në LBR
2	Levofloxacin	500 mg	f.e.tabl.	7	91.8	642.60	Nuk është në LBR
3	Rivaroxaban	15 mg	f.e.tabl.	30	274.14	8,224.20	Është në LBR
4	Abixaban	5 mg	f.e.tabl.	60	137.35	8,241.00	Është në LBR
5	Dexamethasone mg	0.5 tablet	f.e.tabl.	56	6.56	367.36	Është në LBR
6	Vitamin C	100 mg	tablet	140	3.33	466.20	Nuk është në LBR
7	Vitamin D	10000 u.i	tablet	30	24.43	732.90	Është në LBR
8	Paracetamol	500 mg	tablet	20	6.16	123.20	Nuk është në LBR
9	Ibuprofen	400 mg	f.e.tabl.	10	5.13	51.30	Është në LBR
Vlera totale						10,917.60	

Burimi: Kontrolli i Lartë i Shtetit

Në analizën e koston së medikamenteve, sipas udhëzimit të komitetit të ekspertëve, nuk është përcaktuar sa është efekti në buxhetin e FSDKSH-së të medikamenteve jashtë listës LRB-së dhe kush janë importuesit e tyre, apo depot farmaceutike që i disponojnë këto medikamente.⁴⁹

6. Të sëmurët u përballën me kosto të larta të kurimit jashtë spitalit

Kostot e kurimit të COVID-19 jashtë spitalit kanë rezultuar katastrofike për të infektuarit në Shqipëri. Në vitin 2018, para se fillonte pandemia, pagesat nga xhepi të shqiptarëve për trajtimin e çështjeve shëndetësore ishin sa 44.6% të koston së trajtimit.⁵⁰ Shqipëria bën pjesë në grupin e vendeve me pagesa shumë të larta nga xhepi. Para pandemisë,

⁴⁹ <https://panel.klsh.org.al/storage/phpybUmL6.pdf>

⁵⁰ <https://data.worldbank.org/indicator/SH.XPD.OOPC.CH.ZS?locations=AL>

së paku 10% e familjeve shqiptare janë përballur me pagesa katastrofike për shëndetin, të cilat janë bërë shkak për varfërimin e tyre.⁵¹

Me ardhjen e pandemisë në vitin 2020, pagesat nga xhepi dhe ato katastrofike janë rritur më tej. Deri më tani nuk ka studime që tregojnë të dhëna të detajuara mbi kostot e kurimit të COVID-19 jashtë spitaleve publike, por të dhënat me fokus grupet me pacientë, mjekë dhe farmacistë tregojnë se ato kanë qenë shumë të larta në krahasim me trajtimet rutinë të bëra më parë.

Recetat për një person përgjatë dy viteve të pandemisë ishin me vlera shume të larta në shumë raste. Ka raste që një person ka blerë mjekime që kanë kaluar vlerën e 6000 Eurove për trajtim në shtëpi. Përveç medikamenteve, shpenzimet më të larta ishin për disa mjekime kontrabandë, të tilla si Remdisivir dhe Favira.

Shpenzimet mesatare për një të sëmurë me simptoma të lehta kanë arritur edhe në 1000 Euro, ku kryesisht kanë kushtuar ekzaminimet analizat e gjakut, skaner për verifikimin e pasojave, trajtime me vitamina etj, ndërsa të sëmurët me simptoma të moderuara kanë harxhuar deri në 6000 Euro për trajtim në shtëpi. Të tjerë që janë kuruar në spitalet private dhe në Turqi kanë shpenzuar shuma deri në 100,000 Euro.⁵²

7. Aneks 1 - Kosto e kurimit jashtë spitalit

Rasti 1

H. Ismailukaj, 57 vjeçe: jam infektuar me COVID-19 në shtator të vitit 2021. Fillimisht nisi si një virozë e zakonshme dhe dy javët e para nuk mora ekzaminim. Më pas u rëndova me temperaturë, kollë dhe lodhje ekstreme. Nga dita e dhjetë e infektimit bëra një skaner. Ekzaminimet e para më treguan mbi 85% prekje në mushkëri. Më pas nisa trajtimin bazuar në vizita ambulatorie. Kam shpenzuar rreth 8 mijë Euro. Shpenzimet më të mëdha ishin për 5 muaj trajtim me oksigjen, pasi rikuperimi pas COVID-19 ishte shumë i vështirë. Rreth 1000 Euro kanë kushtuar vetëm Aktemra dhe Remdisivir. Kam përdorur mjekime të gjeneratave të veçanta. Pasi jam infektuar me COVID-19 janë shndërruar e sëmurë kronike dhe tani me duhet të shpenzoj çdo muaj për mjekime rehabilituese rreth 100 Euro.

Rasti 2

Gj. Uka, 67 vjeç: Jam infektuar në qershor 2021. Pasi i u infektova me COVID-19 kam marrë trajtim intensiv në shtëpi. Shpenzimet e mia ishin rreth 4000 mijë euro gjithsej. Më shumë më kanë kushtuar analizat çdo tri ditë, skanerë, pagesa për oksigjenin dhe antibiotikë. Para se të infektohesha unë vuaja nga një varg sëmundjesh, si diabeti, insuficienca kardiake, mbipesha. Me kalimin e COVID-19 gjendja shëndetësore më është përkeqësuar më tej dhe po harxhoj çdo muaj për t'u rehabilituar. Për të përballuar shpenzimet po më ndihmojnë fëmijët.

⁵¹ file:///C:/Users/User/Downloads/WHO-EURO-2020-1357-41107-55852-eng%20(1).pdf

⁵² Të dhëna me fokus grupe, tre farmacistë, tre mjekë dhe tre pacientë

Rasti 3

A. Toshi, 56 vjeç: Jam infektuar në shkurt 2021. Mbasi u diagnostikova nisa të kurohem në shtëpi. Nuk doja të shtrohesh në spital pasi nuk kisha garanci nëse do dilja gjallë. Në rastin më të keq doja të vdisja pranë të afërmeve. Kam shpenzuar gjithsej rreth 3000 mijë Euro gjatë periudhës së trajtimit tri javor. Shpenzimet më të mëdha i kam bërë për Remdesivir (rreth 1200 Euro) dhe pastaj më kanë kushtuar oksigjeni dhe shërbimi infermior në shtëpi. Tani jam shëruar, ndihem mirë, por rikuperimin e plotë e kam bërë pas 6 mujash.

8. Paketa anti-COVID nuk pati interes nga të infektuarit

Paketa e rimbursimit për pacientët kishte shumë pak interes, pasi në shumë raste ata që kishin simptoma dhe u kuruan në shtëpi harxhuan shumë më tepër se tavanet në paketën e rimbursimit, që ishin rreth 1700 lekë (14 Euro) me simptoma të lehta dhe 11,000 lekë (rreth 90 Euro) me ato më të rënda. Të infektuarit i morën trajtimet duke u konsultuar me mjekë ambulatorë dhe në bazë të ecurisë së ekzaminimeve me skaner dhe analizave laboratorike⁵³. Të sëmurët nuk ishin të informuar për procedurat e përfitimit dhe shpesh kanë pohuar se nuk kishin njohuri për procedurat e informimit. Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor nuk kanë zhvilluar fushata informimi se si do të përfitonin të interesuarit nga paketa e rimbursimit.⁵⁴

9. Aneks 2 - Dëshmitë e mjekëve dhe farmacistëve

P. Malaj, mjek pneumolog: Pacientët nuk ishin të informuar për paketën e rimbursimit. Shpesh shpenzimet që ato kanë kryer për antibiotikë, hollues, vitamina etj., kanë qenë shumë më të larta se paketa e rimbursimit për të sëmurët rëndë (prej 11000 lekësh). Nga informacionet që kam, mungesa e informacionit për paketën e rimbursimit dhe vlera e ulët e paketave kanë qenë faktorë që interesin e aplikimeve nga të infektuarit ishte i ulët.

A. Braho, mjek pneumolog: Unë punoj në sektorin privat. Gjatë periudhës së pandemisë kam trajtuar shumë pacientë. Ne nuk kishim asnjë njoftim, as protokoll nga entet publike për të sqaruar pacientët rreth procedurave të rimbursimit. Në dijeninë time, kishte shumë pak informacion pse mund të përfitohej. Nga pacientët që unë kam trajtuar nuk kam dijeni që ndonjëri ka përfituar rimbursimin. Pacientët me

⁵³ Fokus grup me tre mjekë ambulator

⁵⁴ <https://fsdksh.gov.al/>, <https://shendetesia.gov.al/>

simptoma të rënda shpesh kanë shpenzuar mijëra Euro.

Irma E., farmaciste në Tiranë: Gjatë vitit të kaluar kisha vetëm 30 rimbursime për paketën anti-COVID-19, të cilat nuk zinin as 0.5% të rimbursimeve që ne bëjmë për medikamente të sëmundjeve të tjera. Në dijeninë time, nuk kanë përfituar për shkak të kriterëve. Së pari duhet të kishe patjetër tampon pozitiv. Për shkak të kapaciteteve të ulëta të tamponimit, shumë pacientë nuk e kanë bërë diagnozën me tampon, por ndërkohë e kanë marrë diagnozën me radiologji. Gjithashtu që të përfitoje nga paketa duhet të kishe D-dimerin e lartë në mënyrë që të përfitoje Xarelton. Edhe gjatë vitit 2022 ka kërkesa për rimbursim, por janë shumë të rralla.

10. Kapacitete të dobëta financiare për të mbrojtur financiarisht të infektuarit

Shqipëria ka shpenzime të ulëta buxhetore për shëndetësinë, në raport me madhësinë e ekonomisë. Në vitin 2021 ato ishin sa 3.3% e PBB-së, një nga nivelet më të ulëta në Evropë⁵⁵.

Financimet e ulëta publike për sektorin e shëndetësisë në Shqipëri lidhen me kapacitet e dobëta fiskale të vendit. Para pandemisë shpenzimet buxhetore në total ishin sa 29% e Prodhimit të Brendshëm Bruto, më i ulëti në Evropë, duke krijuar pak hapësira për investime në sektorin e shëndetësisë.

Krahas nivelit të ulët të investimeve në sektorin publik, Shqipëria ka më pak mjekë në dispozicion të popullatës së saj, me 16 mjekë për 10 mijë banorë, të paktën dy herë më pak se mesatarja e Evropës, prej 47.6 mjekësh për 10 mijë banorë.

Shpenzimet publike në shëndetësi, shprehur si përqindje ndaj PBB, kanë shënuar rritje vjetore me 0,23 pikë përqindje me 2021, ndërkohë shprehur si përqindje ndaj shpenzimeve publike gjithsej, kanë shënuar rritje me 1,01 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2020⁵⁶.

Numri i vdekjeve në vitin 2021 është 30.507, duke shënuar një rritje prej 10,5% krahasuar me një vit më parë.

Të dhënat e deritanishme tregojnë se pasojat e pandemisë në vend kanë qenë më të rënda, në krahasim me vendet e tjera të Evropës dhe rajonit, si në humbjen e jetëve ashtu dhe në rritjen e shpenzimeve nga xhepi për përballimin e kurimit.


⁵⁵ <http://www.instat.gov.al/al/publikime/librat/2022/shqip%C3%ABria-n%C3%AB-shifra-2021/>;
<https://ec.europa.eu/eurostat/web/products-eurostat-news/-/ddn-20220311-1>

⁵⁶ <http://www.instat.gov.al/media/10320/shqiperia-ne-shifra-2021.pdf>

Në vitin 2020, familjet shqiptare i rritën shpenzimet për shëndetësinë me 28%, ndërsa në Bashkimin Evropian ky tregues ra me rreth 4%. Në këtë mënyrë Shqipëria shënoi rritjen më të lartë të shpenzimeve për shëndetin në Evropë, e matur me ndryshimin vjetor të konsumit final të njësive ekonomike familjare (me çmime korente).

Pandemia COVID-19 e ka përkeqësuar edhe më tej këtë trend, sipas të dhënave indirekte për rritjen e shpenzimeve për shëndetin në buxhetin e njësive familjare. Situata e shkaktuar nga pandemia në vitin 2020, e shoqëruar me mbingarkesën në spitale dhe mungesën e besimit të sistemit shëndetësor publik, solli ndryshime në strukturën e shpenzimeve për familjen, duke u orientuar drejt shëndetit. Pesa e shpenzimeve për shëndetin u rrit në 5.4% të totalit të buxhetit të një familjeje në vitin 2020, nga 4.3% vitin e mëparshëm, sipas Anketës së Buxhetit të Familjes⁵⁷.

Grafiku 23: Shpenzimet publike në shëndetësi (%)



Burimi: Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave

⁵⁷ http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/START__HBS__CE/CE0012/?rxid=b5069c81-9c75-4560-905a-2cb719af3ada

Referenca

- Raportet e Monitorimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, 2018-2021 dhe 4 mujori i parë 2019-2022

<https://shendetesia.gov.al/tabelat-e-raportimit-per-intervalet-kohore-3-muaj-9-muaj-dhe-vjetore-si-dhe-relacionet-perkatese/>

- Të dhëna për vdekshmërinë shtesë

<http://instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/lindjet-vdekjet-dhe-martestat/publikimet/2022/treguesit-demografik%C3%AB-t1-2022/>

<http://instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/lindjet-vdekjet-dhe-martestat/publikimet/2021/treguesit-demografik%C3%AB-t4-2021/>

<https://ourworldindata.org/excess-mortality-covid>

https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/dem_r_mwks/default/table?lang=en

- Treguesit fiskalë të konsoliduar të buxhetit të shtetit:

<http://financa.gov.al/statistika-fiskale-mujore/>

Fondacioni Westminster për Demokraci (WFD) është organ publik i Mbretërisë së Bashkuar i dedikuar për të mbështetur demokracinë në mbarë botën. Duke vepruar ndërkombëtarisht, WFD punon me parlamentet, partitë politike dhe grupet e shoqërisë civile, si dhe me zgjedhjet për të ndihmuar shtetet të kenë sisteme politike më të drejta, më gjithëpërfshirëse dhe të përgjegjshme.



www.wfd.org



@WFD_Democracy



@WestminsterFoundation



Fondacioni Westminster për Demokraci
është një organ ekzekutiv publik i sponsorizuar
nga Ministria e Punëve të Jashtme,
Komonuelthit dhe Zhvillimit.

